

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1060 Rep.

Nr. 22 Kol.



AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SWARCO ALBANIA" SHPK.

Sot me 3.5.2005 (dymije e pese), para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht:

- **Fatmir Bektashi**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 24 Nëntor 1957, mbajtës i pasaportës me nr. Z0158246,;
- **Pandeli Carapuli**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 23.07.1953, mbajtës i pasaportës nr. Z0184436;

Te gjithë madhore e me zotesi te plote per te vepruar, te cilet nepermjet ketij akti themelojne sot me vullnetin e tyre te lire e te plote nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas dispozitave te meposhteme:

Neni I.

Krijimi dhe Emertimi

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "SWARCO ALBANIA" Shpk, me poshte e quajtur "Shoqeria".

Neni II.

Selia e Shoqerise

Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: EUROCOL - Business Center, Rr. Murat Toptani, Tirane, Shqipëri. Me vendim te organit administrativ sipas dispozitave te kësaj marrëveshje, Shoqëria mund te hape zyra përfaqësie, dege, dhe/ose te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

Neni III.

Objekti i Aktivitetit

Shoqëria ka për objekt: (i) prodhimin e materialeve ne lidhje me sinjalistiken e sigurinë ne rruge; (ii) zbatimin e punëve ne lidhje me sigurinë ne rruge, pa u kufizuar ne to, si:

- shënimin e vijëzimin e rrugëve;
- instalimin e mirëmbajtjen e semaforëve;
- administrimin e qarkullimit;
- tabelizimin e rrugëve;

mbrojtjen anësore të rrugëve, dhe në përgjithësi instalimin e mirëmbajtjen e gjitha pajisjeve të tjera të nevojshme për sigurimin në rrugë.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar, që i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo arritjes së objektit të saj si me sipër, përfshirë edhe importin dhe eksportin e materialeve dhe makinerive.

Shoqëria, me vendim të organit administrativ, dhe aty ku është parashikuar në këtë marrëveshje pas miratimit paraprak të asamblesë së ortakëve, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të saj. Për këtë arsye, Shoqëria mund të lidhë marrëveshje apo kontrata qiraje, shitje e hipotekimi të pasurive të paluajtshme, si dhe të ofrojë garanci të tjera personale apo reale.

Neni IV.

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Regjistrin Tregtar.

Neni V.

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 18.355.000 Leke (tetëmbëdhjetë milionë treqind pesëdhjetepesë mijë) i cili është i ndarë në 18.355 (tetëmbëdhjetë mijë treqind pesëdhjetepesë) kuota me vlerë nominale 1.000 Leke (një mijë) secila. Kapitali i shoqërisë përbehet nga kontributet në natyrë sipas inventarit bashkëngjitur kësaj marrëveshje, vlerësuar nga një Ekspert për Vlerësimin e Kontributeve në Natyrë emëruar me vendim unanimit të ortakëve dhe nënshkruhet menjëherë, përkatësisht nga ortakët:

- **Fatmir Bektashi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me datë 24 Nëntor 1957, mbajtës i pasaportës me nr. Z0158246, zotërues i 8.968 kuotave, me vlerë të përgjithshme 8.968.000 (nëntë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tete) Leke, që përbejnë 49% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Pandeli Carapuli**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë me datë 23.07.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z0184436, zotërues i 9.387 kuotave, me vlerë të përgjithshme 9.387.000 (nëntë milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) Leke, që përbejnë 51% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar të Shoqërisë kryhet sipas vendimit unanimit të Asamblesë së Ortakëve.





Neni VI.

Administrimi i Shoqerise

Administrimi i Shoqerise kryhet nga nje Administrator i Vetem. Administratori i Vetem, kryhen administrimin e aktivitetit te zakonshem dhe ate te jashtezakonshem te Shoqerise.

Administratori i Vetem emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve sipas kushteve te përcaktuara ne statutin e shoqërisë. Administratori i Vetem emerohet per nje periudhe kohore prej një viti.

Administratori i Vetem do te realizoje detyrat e tij duke kryer te gjitha veprimet qe i konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe statuti dhe ligji i ka rezervuar Asamblese se Ortakeve.

Administratori i Vetem eshte perfaqesuesi ligjor i Shoqerise, dhe vepron ne emer e per llogari te saj. Administratori i Vetem mund t'i delegoje nepunesve te tjere te shoqerise disa nga detyrat e tij organizative apo manaxhuese.

Administratori i Pare i Shoqerise është: Z. Fatmir Bektashi, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 24 Nëntor 1957, mbajtës i pasaportës me nr. Z0158246. Adresa e administratorit: Rr. Sulejman Delvina, P. 140, Shk. 1, Ap. 4, Tirane, Shqipëri .

Neni VII.

Dispozitat e Organizimit

Dispozitat mbi organizimin, si dhe rregullat mbi drejtimin e administrimin e aktivitetit te Shoqerise dhe çeshtjeve te brendshme, jane parashikuar ne Statutin e saj i cili modifikohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Une Noteri lexoj me ze te larte tekstin e ketij dokumenti. Ortaket Themelues pasi njihen me permbajtjen e tij, dhe pasi e gjejne ate ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, e nenshkruajne rregullisht ne pranine time dhe une Noteri vertetoj kete dokument sipas ligjit.

Nenshkruhet sot me date 3.5.2005 nga Ortaket:

Pandeli CARAPULI

Fatmir BEKTASHI



EMERTIMI – SELIA - KOHEZGJATJA

Neni 1. –

Emertimi i Shoqërise

1.1 Emertimi i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar është “SWARCO ALBANIA” Shpk, me poshte e quajtur “Shoqëria”.

Neni 2. –

Selia

2.1 Selia e Shoqërise ndodhet në adresën: Eurocool Business Center, Rr. Murat Toptani, Tiranë, Shqipëri. Me vendim të organit administrativ sipas dispozitave të kësaj marrëveshje, Shoqëria mund të hapë zyra perfaqësie, dege, dhe/ose të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3. –

Kohezgjatja

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Regjistrimit Tregtar.

OBJEKTI

Neni 4. –


Objekti i Shoqërise

4.1 Shoqëria ka për objekt: (i) prodhimin e materialeve në lidhje me sinjalistikën e sigurinë në rrugë; (ii) zbatimin e punëve në lidhje me sigurinë në rrugë, pa u kufizuar në to, si:

- shenimin e vijeve të rrugëve;
- instalimin e mirembajtjes së semaforeve;
- administrimin e qarkullimit;
- tabelizimin e rrugëve;
- mbrojtjen anësore të rrugëve, dhe në përgjithësi instalimin e mirembajtjes së gjitha pajisjeve të tjera të nevojshme për sigurimin në rrugë.

4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar, që i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo arritjes së objektit të saj si me sipër, përfshirë edhe importin dhe eksportin e materialeve dhe makinerive.

4.3 Shoqëria, me vendim të organit administrativ, dhe aty ku është parashikuar në këtë marrëveshje pas miratimit paraprak të asamblese së ortakeve, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të saj. Për këtë



ansye, Shoqëria mund të lidhë marrëveshje apo kontrata qiraje, shitje e ipotekimi të pasurive të paluajtshme, si dhe të ofrojë garanci të tjera personale apo reale.

KAPITALI, TË DREJTAT E ORTAKEVE, TRANSFERIMI I KUOTAVE, PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË

Neni 5. –

Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 18.355.000 Lëke (tetëmbëdhjete milionë treqind pesëdhjetepesë mijë) i cili është i ndare në 18.355 (tetëmbëdhjete mijë treqind pesëdhjetepesë) kuota me vlerë nominale 1.000 Lëke (një mijë) secila. Kapitali i shoqërisë përbehet nga kontributet në natyrë sipas inventarit bashkëngjitur kësaj marrëveshje, vlerësuar nga një Ekspert për Vlerësimin e Kontributeve në Natyrë emëruar me vendim unanimit të ortakëve dhe pranohet dhe nënshkruhet menjëherë, përkatësisht nga ortakët:

- **Fatmir Bektashi**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me datë 24 Nëntor 1957, mbajtës i pasaportës me nr. Z0158246, zotërues i 8.968 kuotave, me vlerë të përgjithshme 8.968.000 (nëntë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tete) Lëke, që përbejnë 49% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- **Pandeli Carapuli**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë me datë 23.07.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z0184436, zotërues i 9.387 kuotave, me vlerë të përgjithshme 9.387.000 (nëntë milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) Lëke, që përbejnë 51% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

5.2 Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar të Shoqërisë kryhet sipas vendimit unanimit të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 6. –

Përgjegjësia e Ortakëve për Detyrimet e Shoqërisë

6.1 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

Neni 7.—

Te Drejtat e Ortakëve

7.1 Kuotat e pjesëmarrjes në kapital u japin ortakëve në asamblenë e përgjithshme të drejtat dhe detyrimet që u njihen me ligj. Në mënyrë me specifike, ortakët në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes në kapital kanë të drejtë të marrin pjesë në fitimin e Shoqërisë, në asetet e saj në rastin e prishjes, si dhe të ushtrojnë çdo të drejtë tjetër që u njihet nga legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare.

Neni 8. –

Transferimi i Kuotave të Kapitalit tek të Tretët

8.1 Kuotat e Shoqerise mund t'u transferohen te treteve vetem pasi t'u jene ofruar paraprakisht per shitje ortakeve te tjere. Oferta per shitje u drejtohet te gjithe ortakeve me shkrim. Ortaket e tjere kane 90 (nentedhjete) dite per te ushtruar te drejten e tyre te parablerjes. Vlera e shitjes se kuotave do te percaktohet me mirekuptim mes paleve pas nje raporti vleresimi te pergatitur nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Neni 9. –

Financimi i Shoqerise

9.1 Organi Administrativ i Shoqerise, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, perveç rasteve te zmadhimit te kapitalit, ka te drejte te kerkoje nga ortaket fondet e nevojshme per arritjen e objektit te Shoqerise.

9.2 Financimet e metejshme te ortakeve do te jene me shperblim (interesa) apo pa shperblim, ne varesi te titullit nepermjet te cilit jepen keto fonde.

Neni 10. –

Barret mbi Kuotat e Kapitalit

10.1 Kuotat e kapitalit te Shoqerise mund te rendohen lirisht me barre siguruese apo te drejta te tjera reale.

VENDIMET E ORTAKEVE

Neni 11. –

Asambleja e Ortakeve

11.1 Asambleja e Ortakeve vendos per çeshtjet qe ligji apo kjo marrëveshje ia rezervon ketij organi, si dhe per çeshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Ortakeve.


11.2 Vendimet e Asamblese se Ortakeve merren me voten e shumices se ortakeve te shoqerise, qe perbejne mbi 50% te kapitalit themeltar te saj, perveç rasteve kur dispozitat urdhëruese sipas legjislacionit ne fuqi apo normat e ketij statuti, kërkojnë një tjetër shumice.

Neni 12. –

Konsultimi me Shkrim i Ortakeve

12.1 Duke mbetur te pacenuara dispozitat e nenit 13 me poshtë, vendimet e Ortakeve mund te merren pas nje konsultimi me shkrim qe organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Ne kete rast, organi administrativ i komunikon Ortakeve tekstin e projekt-vendimit qe do te merret, dhe i kerkon te shprehin vullnetin e tyre ne lidhje kete çeshtje.

12.2 Vendimet e marra ne kete menyre jane te vlefshme vetem nese te gjithe Ortaket kane miratuar me shkrim permbajtjen e konsultimit.




Neni 13. –

Menyra dhe Vendi i Thirrjes se Asamblese se Ortakeve

13.1 Asambleja e Ortakeve thirret prane selise se Shoqerise, apo ne nje vend tjetër, nepermjet nje njoftimi me shkrim qe organi administrativ i dergon Ortakeve.

13.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se Asamblese duhet te kryhet te pakten 4 (katër) jave përpara datës se mbledhjes nëpërmjet një letre rekomande (poste ajrore) dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e Asamblese se Ortakeve mund te thirret nga Eksperti Kontabel i Autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume Ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te Shoqerise.

Neni 14. –

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve

14.1 Asambleja e pergjithshme zhvillohet ne seline e shoqerise, ose ne cdo vend tjetër brenda ose jashte Republikes se Shqiperise. Asambleja drejtohet nga Kryetari i saj. Ortaket zgjedhin Kryetarin e Asamblese ne cdo mbledhje.

14.2 Vendimet e asamblese se pergjithshme mund te merren vetem nese ne mbledhje jane te pranishem te gjithe ortaket qe perbejne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise. Ne rast se nuk sigurohet shumica si me siper, duhet te thirret menjehere nje mbledhje e re e asamblese se pergjithshme, ose duhet te behet nje konsultim me shkrim sipas nenit 12 te kësaj marrëveshje. Asambleja e mbledhur për here te dyte, mund te adoptoje vendimet e saj pa qene nevoja qe te jene te pranishem ortaket qe perfaqesojne 100% te kapitalit themeltar.

14.3 Vendimet e Asamblese do te konsiderohen te vlefshme, edhe ne rast se menyra e lajmerimit sipas ligjit ose kontrates nuk eshte respektuar, ne qofte se te gjithe ortaket e pranishem ose te perfaqesuar jane dakord.

14.4 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimimin e perfaqesuesit te Ortakeve, dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.

14.5 Kryetari Asamblese me ndihmen e sekretarit harton proces verbalin e mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve, dhe pasi i lexon Ortakeve tekstin e ketij dokumenti, e verteton ate nepermjet nenshkrimit.

14.6 Proces-verbalet e asambleve dhe vendimet e marra nga ortaket duhet te mbahen ne menyre te rregullt dhe te ruhen ne kopje origjinale prane selise se shoqerise. Nje kopje me shkrim e vendimeve te marra duhet t'iu dergohet ortakeve pa vonese pas mbarimit te




asamblese ose pas procedures se votes me shkrim, duke permendur daten e aktit sipas proces verbalit te asamblese.

Neni 15. –

Pjesemarrja ne Vendime

15.1 Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te Shoqërise qe ai zoteron. Nje Ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e Asamblese nga nje Ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje prokure me shkrim.

Neni 16.—

Dispozite kufizuese, Marrëveshja e distribucionit

16.1 Ortaket, gjate statusit te tyre si ortake te Shoqërisë dhe një vit pas tërheqjes se tyre nga Shoqëria, nuk do te kryejnë aktivitete te cilat ne mënyre te drejtpërdrejte ose jo konkurrojnë Shoqërinë ne aktivitetin e saj, ose te marrin pjese ne shoqëri te tjera konkurrenente. Ortaket duhet te veprojnë dhe te ushtrojnë te drejtën e tyre te votës ne përputhje me këtë detyrim. Kjo dispozite e marrëveshjes nuk mund te ndryshohet nga ortaket.

16.2 Ne rastin e mbarimit te marrëveshjes se distribucionit me Swarco Europe GmbH, Shoqëria dhe Ortaket marrin përsipër te mos përdorin eksperiencën qe iu është dhëne nga Swarco Europe GmbH, ashtu si edhe emrat dhe markat e produkteve ne pronësi te saj te parashikuar ne marrëveshjen e distribucionit, ne mënyre specifike emërtimin "Swarco" dhe emërtime te tjera te ngjashme. Ortaket duhet te veprojnë dhe te ushtrojnë te drejtën e tyre te votës ne përputhje me këtë detyrim. Kjo dispozite e marrëveshjes nuk mund te ndryshohet nga ortaket.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE


Neni 17. –

Administrimi i Shoqerise

17.1 Administratori i shoqerise emerohet nga ortaket per nje periudhe nje vjeçare, me te drejte rizgjedhje sipas vendimit te asamblese se ortakeve. Administratori është përgjegjës kundrejt ortakeve per administrimin e shoqerise, dhe duhet t'i raportoje atyre ne menyre periodike ose sipas kerkeses.

17.2 Administratori i shoqerise mund te jete administrator edhe ne shoqeri te tjera, me kusht qe keto te fundit te mos jene shoqeri konkurrenente, qe kane te njejtin objekt aktiviteti te percaktuar ne nenin 4.1.

17.3 Administratori është përgjegjës për administrimin e perditshem te shoqerise. Administratori perfaqeson shoqerine kundrejt paleve te treta, autoriteteve, bankave dhe autoriteteve gjyqesore. Administratori eshte pergjegjes per veprimet e kryera ne administrimin e shoqerise sipas kësaj marrëveshje dhe legjislacionit shqiptar. Kompetencat




e administratorit mund te ndryshohen nga ortaket here pas here. Administratori do te veproje si nje profesionist i kujdesshem dhe ne interes te shoqerise.


17.4 Administratori i shoqerise do te:

1. zbatoje vendimet e ortakeve;
2. pergatise dhe firmose dokumentat financiare vjetore te shoqerise;
3. pergatise dhe paraqese ortakeve raportin vjetor mbi aktivitetet e shoqerise dhe gjendjen e aseteteve te saj;
4. te perkujdeset qe dokumentat financiare te shoqerise te mbahen ne menyren e duhur;
5. te beje propozime mbi shperndarjen e fitimit;
6. te zbatoje te gjitha detyrat qe i caktohen ne menyre periodike nga ortaket;
7. te perkujdeset qe shoqeria te ushtroje aktivitetin e saj duke respektuar legjislacionin shqiptar dhe ka te gjitha fuqite qe te kryeje te gjitha aktet e nevojshme per ushtrimin e aktivitetit;
8. te ushtroje te gjitha te drejtat e punedhenesit ne lidhje me te punesuarit;
9. te kete qendren kryesore te administrimit te shoqerise prane selise se saj.

17.5 Administratori duhet te respektoje te gjitha direktivat e ortakeve dhe te zbatoje te gjitha aktet per te cilat kerkohet aprovimi paraprak i asamblese se ortakeve.

Veprimet e administratorit per te cilat eshte i nevojshem aprovimi paraprak i asamblesë se përgjithshme te ortakeve jane:

1. Krijimi i rezervave ligjore dhe/ose sipas statutit;
2. Kryerja e veprimeve dhe pjesemarrja ne veprimtari qe dalin jashte objektit te Shoqerise si dhe hapja ose mbyllja e filialeve, degeve apo mundesia e krijimit te tregjeve te reja;
3. Pjesemarrja ne kapitalin e shoqerive te tjera, ashtu si edhe shitja apo vendosja ne garanci e ketyre pjesemarrjeve;
4. Blerja, shitja dhe hipotekimi apo te drejta te tjera reale mbi pasurite e patundshme, ashtu si edhe lidhja e kontratave te qiradhenies apo qiramarrjes ne lidhje me pasurite e patundshme;
5. Ndertimi i ndertesave te reja ose zgjerimi i atyre ekzistuese, ashtu si edhe te tjera ndertime apo riparime, me perjashtim te atyre rasteve kur keto veprime jane nderrmare ne kuadrin e nje plani investimi te miratuar nga asambleja e ortakeve;
6. Blerja, ndertimi ose shitja e pasurive te luajtshme te shoqerise ne vlere me te madhe se Eur 20.000,00 (njetzet mije) per secilin transakcion ose per transakcione te cilat ne total arrijne nje vlere me te madhe se Eur 100.000,00 (njqind mije) gjate gjithe vitit fiskal perkates;
7. Blerja ose shitja e te drejtave qe rrjedhin nga pronesia intelektuale apo licencave te ndryshme;





8. Marrja e kredive dhe huave ne shuma te cilat nuk jane te pershtatshme ne lidhje me planin financiar te shoqerise, ose kohezgjatja e te cilave eshte me e madhe se nje vit, me perjashtim te kredive te furnizuesve gjate aktivitetit te zakonshem te shoqerise;
9. Marrja e kredive nga furnizuesit dhe dhenia e kredive klienteve, te cilat dalin jashte aktivitetit te zakonshem te shoqerise;
10. Dhenia e huave apo kredive te tjera dhe garancive, me perjashtim te garancive te aprovuara nga ortakët ne rastin e nje plani investimi;
11. Nenshkrimi i kontratave ne lidhje me mallra apo sherbime, te cilat nuk jane te lidhura drejtperdrejt me aktivitetin e zakonshem te shoqerise;
12. Nenshkrimi i marreveshjeve te qirase apo koncesioneve;
13. Te tjera kontrata apo aktivitete te cilat nuk jane te lidhura drejtperdrejt me aktivitetin e zakonshem te shoqerise;
14. Nenshkrimi, ndryshimi apo zgjidhja e kontratave me:
 - a) Administratorin/ret ose anetare te familjes se tij/tyre, ne qofte se eshte rasti;
 - b) Shoqeri ne te cilat administratori/et ose familja/et i/e tyre kane nje interes direkt ose indirekt, ne qofte se eshte rasti;
15. Operacione ne burse, ne menyre te vecante blerja apo shitja e letrave me vlere;
16. Dhenia e prokurave per perfaqesimin e shoqerise;
17. Zgjidhja e problemeve te rendesishme ne lidhje me personelin, ashtu si edhe ceshtje qendrore ne lidhje me organizimin e shoqerise;
18. Nenshkrimi i kontratave me drejtoret/administratoret e shoqerive te tjera ne te cilat shoqeria ka pjesemarrje kapitali;
19. Perfaqesimi dhe marrja e vendimeve te rendesishme ne ceshtjet dhe mosmarreveshjet ligjore;
20. Pergatitja e planit vjetor te blerjeve, prodhimit dhe investimit dhe planit vjetor financiar.

17.6 Ndryshimi i listes se mesiperme te akteve per te cilat administratori ka nevojë per pelqimin paraprak te ortakeve mund te behet ne çdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.

17.7 Përveç akteve te mesiperme per te cilat nevojitet pelqimi paraprak i ortakeve, administratori duhet t'iu njoftoje atyre te gjitha aktet e nderrmara ne lidhje me administrimin e Shoqerise dhe rezultatet e arritura ose te pritshme.

17.8 Ortaket mund t'i akordojne personave te trete, perveç administratorit, kompetencen per te perfaqesuar Shoqerine ne çdo kohe. Prokurat do te regjistrohen ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane. Ne mungese te prokurave te shkruara, te gjitha aktet e nenshkruara nga nje person i trete perveç administratorit te shoqerise, do te konsiderohen te pavlefshme. Administratori i shoqerise mund t'i transferoje

te brejtat dhe detyrimet e tij te treteve ne çdo kohe, por vetem me aprovimin paraprak te ortakëve.

17.9 Administratori i pare i shoqerise eshte: Z. Fatmir Bektashi, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 24 Nëntor 1957, mbajtës i pasaportës me nr. Z0158246. Adresa e administratorit: Rr. Sulejman Delvina, P. 140, Shk. 1, Ap. 4, Tirane, Shqiperi.

17.10 Personi i siperpermendur ushtron i vetem te gjitha kompetencat qe kjo marrëveshje i njej funksionit te administratorit te shoqerise.

VITI FINANCIAR DHE BILANCI

Neni 18. -

Viti Financiar

18.1 Viti Financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

Neni 19.--

Dokumentet financiare

19.1 Shoqëria i mban dokumentet e saj financiare konform ligjit shqiptar.

Neni 20.--

Bilanci dhe pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

20.1 Bilanci dhe pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve te vitit fiskal paraardhes duhet te pergatiten dhe t'i paraqiten ortakëve brenda tre muajve te pare te vitit fiskal pasardhes.

Neni 21.--

Llogaritja dhe shperndarja e dividendeve

21.1 Fitimi neto do te percaktohet ne bilancin vjetor te aprovuar nga ortakët, pas krijimit te rezervave ligjore dhe rezervave te tjera te miratuara dhe pas pagimit te tatimit mbi fitimin, sic parashikohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

21.2 Fitimi mund te shperndahet ne formen e dividendit, pasi te miratohet nga asambleja e ortakëve te shoqerise.

Neni 22. -

Kontroli Kontabel

22.1 Kontrolli Kontabël i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabel te Autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakëve do te emeruje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.



PERSONELI I SHOQERISE

Neni 23.--

Personeli i shoqerise

23.1 Administratori mund te punesoje personelin e shoqerise vetem ne baze te nje kontrate te rregullt pune sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 24. –

Prishja dhe Likuidimi i Shoqerise

24.1 Shoqëria mund te perfundoje me:

- a) Vendimin e ortakeve;
- b) Pamundesine e arritjes se objektivit per te cilin eshte krijuar;
- c) Ne cdo rast tjeter te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

24.2 Dispozitat për kryerjen e likuidimit dhe emerimin e likuidatorit jane ato qe parashikohen nga ligji shqiptar ne fuqi.

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Neni 25. –

Ligji i Aplikueshem

25.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me ketë statut dhe me ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete marrëveshje, do te aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

Neni 26.—

Hyrja ne fuqi

26.1 Ky dokument hyn ne fuqi ne daten e firmosjes se tij ne prani te noterit.

Nenshkruhet sot me date __.__.2005, ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe secila me fuqi te njejte.

PANDI CARAPULI

FATMIR BEKTASHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1064 Rep.
Nr. 23 Kol.



VERTETIM I FIRMES SE NENSHKRUESVE

Sot me date 3.05.2005, para meje noteres se Dhomes se Notereve Tirane, *Dagmara Çezaj* paraqiten personalisht: Z. Pandeli Carapuli, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane me date 23.07.1953, mbajtës i pasaportës me nr. Z0184436 dhe Z. Fatmir Bektashi, shtetas Shqiptar, lindur ne Tirane, me date 24 Nëntor 1957, mbajtës i pasaportës me nr. Z0158246. Personat e mësipërm janë te gjithë madhore dhe me zotësi te plote për te vepruar për identitetin e te cilëve u binda nga dokumentet qe me paraqiten. Palët deklarojnë se sa me sipër është nënshkruar prej tyre dhe unë noteria e vërtetoj këtë gjë sipas ligjit.

NOTERE

Dagmara Çezaj